



EXTRA
06.03.15



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA) DHE KOMISIONIT TË PAVARUR TË MEDIAVE (KPM)

Autoriteti i Mediave Audiovizive i Republikës së Shqipërisë (AMA) dhe Komisioni i Pavarur i Mediave i Republikës së Kosovës (KPM), (më poshtë i cilësuar si "Palët");

Duke konsideruar rëndësinë e zhvillimit të mediave audiovizive dhe forcimin e mëtejshëm në bashkëpunimin ndërmjet palëve;

Për t'i shërbyer sa më mirë interesit të qytetarëve dhe bashkëkombësve në të dyja shtetet tona si dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky qëllim, ku përfshihet plotësimi i standardeve të komunitetit në fushën e mediave audiovizive;

Duke patur dëshirën dhe gatishmërinë për të promovuar zhvillimin e lidhjeve nëpërmjet një bashkëpunimi intensiv reciprok në fushën e rregullimit audioviziv;

Mbështetur në nenin 19, pika 2 gërma "d" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-44 "Për Komisionin e Pavarur të Mediave të Republikës së Kosovës"

Janë pajtuar si më poshtë:

Neni 1 Objektivat

Palët angazhohen të forcojnë bashkëpunimin reciprok në fushën e rregullimit të medias dhe të zhvillojnë takime në baza të rregullta, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në fushën e:

1. Shkëmbimit të përvojave respektive të strategjive kombëtare të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike;
2. Shkëmbimit të përvojës për përshtatjen e legjislacioneve respektive me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira;

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në lidhje me:

1. Hartimin e akteve nënligjore përkatëse;
2. Menaxhimin e frekuencave;
3. Rregullimin e çështjeve të përmbajtjeve të programeve; Respektimi i normave etike dhe mbrojtja e të miturve;
4. Shkëmbimin e përvojës për hartimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator për "komunikimet tregtare audiovizuale;

5. Shkëmbimin e përvojës së monitorimit të programeve dhe vlerësimin e përmbajtjes së programit;
6. Rregullimin dhe procedurat e autorizimit dhe të marrëveshjeve me operatorët;
7. Mbrojtjen e të drejtës së transmetimit dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit;
8. Mundësimin e ofrimit të shërbimeve audio dhe audiovizive në baza ligjore reciproke;
9. Shërbimin e transmetimit publik - Roli i transmetuesit publik në erën digjitale;
10. Shkëmbimin e përvojës për transmetimet me akses të kushtëzuar;
11. Metodologjinë e monitorimit për kuotat e transmetimit të veprave audiovizuale evropiane;
12. Shkëmbimin e informacionit për operatorë të ndryshëm që transmetojnë në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës.

Neni 3 Format e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në temat e përmendura në nenin 2, duke përdorur metodat dhe mjetet e mëposhtme;

1. Pjesëmarrja e ekspertëve të dy palëve në takime, konferenca dhe tavolina të rumbullakëta;
2. Angazhimi për krijimin e një ambienti rregullativ reciprok për shërbimet e mediave audiovizive të të dyjave vendeve.
3. Veprimtari të përbashkëta, këshillime, iniciativa për të evidentuar përvojën e palëve në fushën e mediave audiovizive;
4. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta, me pjesëmarrjen e ekspertëve të dy palëve, mbi aspektet e ndryshme të fushës së mediave audiovizive;
5. Organizimin e vizitave studimore;
6. Krijimi i Grupit të Përbashkët të Punës për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit;
7. Realizimi i projekteve të përbashkëta në fushën e monitorimit dhe analizës së programeve, monitorimit dhe planifikimit të frekuencave.

Neni 4 Rregullat e përfaqësimit

Me kërkesë dhe në mbështetje të KPM-së, në organizatat ndërkombëtare në të cilat KPM-ja nuk është ende anëtare, të kryhet përfaqësimi nga AMA në mbrojtje të interesave të saj.

Neni 5 Plani i veprimit

Grupi i Përbashkët i Punës, i krijuar për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, do të mbledhet dy herë në vit, për të hartuar Planin e Veprimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje si dhe për të ndjekur ecurinë e zbatimit të tij. Grupi i Përbashkët i

Neni 6 Zbatimi

Implementimi i Marrëveshjes do të kryhet nga secila palë. Për nivelet e përfaqësimit, datat, vendet dhe tematikat e takimeve, palët do të merren vesh nëpërmjet grupit të përbashkët të punës.

Neni 7 Kohëzgjatja dhe rinovimi

Marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë tre-vjeçare dhe do të rinovohet automatikisht pas këtij afati kohor, për një periudhë tjetër tre-vjeçare, në rast se Palët nuk njoftojnë njëra tjetrën për zgjidhjen gjashtë muaj përpara përfundimit të periudhës së parë.

Secila Palë mund të propozojë ndryshime/shtesa për këtë Marrëveshje, të cilat duhet t'i paraqiten Palës tjetër për miratim. Kur Palët bien dakord pa një datë specifike, ndryshimet/shtesat do të hyjnë në fuqi, kur Palët të njoftojnë njëra-tjetrën mbi miratimin e këtyre ndryshimeve.

Pavarësisht nga përfundimi i kësaj Marrëveshje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të zbatohen për sa u përket projekteve dhe kontratave në zhvillim e sipër, deri në përfundimin e tyre, në rast se Palët nuk vendosin ndryshe.

Marrëveshja është hartuar në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Neni 8 Hyrja në fuqi dhe nënshkrimi

Ky Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Nënshkruar më 06.03.2015

AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Gentian SALA
Kryetar



SALA

KOMISIONI I PAVARUR I
MEDIAVE

Adnan MEROVCI
Kryetar

